REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Nr. 104 Regj.Themeltar.
Nr. 182 Vendimi.

V E N D I M

" NE EMER TE REPUBLIKES "

Gjykata e Apelit Tirane e perbere prej :

KRYESUESE	**:**	**FIQIRETE**	**MULLAJ**
ANËTAR	**:**	**ERVIN**	**METALLA**
ANËTARE	**:**	**MARIA**	**QIRJAZI**

Sot ne dt.24.11.2016 mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe i perket paleve:

KERKUES: **A/S Global Risk Managment Ltd.,** Adresa: Stradvejen 7, 5500Middelfart, Danimarke, perfaqesuar av.Kristaq Profkola.

Person i trete: **Tradin Petrol & Drilling Sh.a,** me NUIS: L21807013N, adresa: Rr. Ibrahim Rrugova, Sky Tower, Kati 10, Tirane, perfaqesuar av.Florian Hasko.

Objekti: Njohja dhe dhenia fuqi ne Republiken e Shqiperise te Vendimit te Arbitrazhit te dates 4 Mars 2016 dhene ne Kopenhagen, Danimarke, nga gjykata e arbitrazhit e perbere nga Stig Bigaard, Jens V.Mathiasen dhe Henrik Rothe;

BAZA LIGJORE: Nenet 393 e vijues te Kodit te Procedures Civile.

GJYKTA E APELIT TIRANE

Pasi degjoi relatoren **F.Mullaj,** perfaqesuesin e pales kerkuese qe kerkoi pranimin e kerkeses, personin e trete qe kerkoi rrezimin e kerkeses, e pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi:

V E R E N

Ne kerkesen drejtuar gjykates kerkuesi A/S Global Risk Managment Ltd. ka kerkuar qe vendimit perfundimtar te Arbitrazhit Nderkombetar t'i jepet fuqi ligjore sipas Legjislacionit te shtetit shqiptar, ne perputhje me nenet 393 e vijues te Kodit te Procedures Civile.
Nga hetimi gjyqesor rezultoi e provuar se:
Midis Kerkuesit, shoqeria A/S Global Risk Managmanet Ltd (me tej "GRM" ose "Global") dhe shoqerise Trading Petrol & Drilling Sha (me tej "TPD") ne daten 25.02.2015 ka lindur nje marredhenie kontraktore per kryerjen e disa transaksioneve te tipit swap (me mbrojtje ndaj riskut te luhatjes se cmimit te naftes) per blerje nafte, ne baze te dy kontratave te njepasnjeshme te nenshkruara ne date 25.02.2015 (bashkelidhur me kete Kerkese si Kontrata dhe Kontrata Marxhinale dhe Kolaterali).
Mes paleve linden mosmarreveshje pasi TPD nuk beri asnje pagese nga ato per te cilat GRM i kishte derguar kerkese dhe duke qene se shuma e detyrimit arriti ne vleren prej 337,440.00 USD (pa perfshire interesat) GRM ne baze te kontratave te nenshkruara nga palet, nderrmori fillimin e procedurave te arbitrazhit ne lidhje me borxhin e saj.
Ne baze te nenit 14 te Kontrates se dates 25 Shkurt 2015, te nenshkruar midis paleve, zgjidhja e mosmarreveshjeve do te behet me ane te procedurave te arbitrazhit.
Neni 14 i Kontrates permban marreveshjen e arbitrazhit dhe parashikon:
"14.1 Keto kushte si dhe Kontrata midis Pales tjeter dhe Global do te qeveriset ne te gjitha ceshtjet nga ligjet e Mbreterise se Danimarkes;
14.2 Cdo mosmarreveshje midis paleve ne lidhje me keto kushte dhe Kontrata do t'i referohet dhe do te zgjidhet perfundimisht nga nje gjykate arbitrazhi qe konsiston ne 3 (tre) arbitra, nje arbiter i zgjedhur nga secila Pale dhe 1(nje) arbiter i zgjedhur nga arbitrat, ose nese ata nuk bien dakord nga presidenti i Gjykates Tregtare dhe Detare te Kopenhagenit. Nese njera nga palet nuk e ka zgjedhur arbitrin brenda 14 diteve pasi eshte kerkuar me nje leter te rekomandimi, nje arbiter do te zgjidhet nga kryetari i gjykates Detare dhe Tregtare te Kopenhagenit,
Vendi i arbitrimit eshte Kopenhageni, Danimarke. Gjuha e arbitrazhit do te jete anglishtja, vetem nese pala tjeter do te jete Daneze atehere gjuha e arbitrazhit do te jete gjuha daneze.
14.3 Gjykata e arbitrazhit vendos per proceduren qe do ndiqet dhe cila nga palet do te jete pergjegjese per pagesen e shpenzimeve te ceshtjes."

Pra ne baze te paragrafit 14.1 te Kontrates, mosmarreveshja midis paleve do te zgjidhej sipas ligjeve te Mbreterise se Danimarkes. Me tej sipas paragrafit te arbitrazhit (paragrafi 14.2 i Kontrates) vendi i arbitrimit do te ishte Kopenhageni, Danimarke. Respektivisht, Akti i Arbitrimit Danez 2015 do te zbatohej ne lidhje me proceduren e arbitrazhit te parashikuar ne Kontrate.

Ne perputhje me paragrafin e arbitrazhit (paragrafi 14.2 i Kontrates) procedurat do te zhvillohen ne anglisht.

Sic rezulton edhe nga vete vendimi i arbitrazhit, ne kerkesen e tij per arbitrazh te dates 13 gusht 2015 paditesi GRM caktoi perfaqesuesin ligjor te tij Z. Jens V. Mathiasen, per te vepruar si bashke-arbiter.
Kerkesa per arbitrazh me 14 gusht 2015 iu dergua me poste tre perfaqesuesve per te padituri TPD te permendur me siper, dhe eshte derguar me poste ne adresen e te pandehurit TPD me date 17 Gusht 2015.
Meqenese pala e paditur TDP nuk e zgjodhi brenda afatit kohor te kontrates se arbitrazhit mes paleve nje arbiter, paditesi ne nje leter te dates 1 Shtator 2015 ne perputhje me kontraten e arbitrazhit i kerkoi kryetarit te Gjykates se Larte Detare dhe Tregtare te Kopenhagenit, te emeroje nje bashke-arbiter ne emer te pales se paditur.
Kryetari i Gjykates se Larte Detare dhe Tregtare ne nje e -mail te dates 30 Shtator 2015 emeroi avokatin Stig Bigaard, si bashke-arbiter dhe i kerkoi te njoftoje TPD per emerimin e tij, te cilen beri me e-mail te dates 22 Tetor 2015.
Bashke-arbitrat i kerkuan Kryetarit te Gjykates se Larte Detare dhe Tregtare Kopenhagen, Z.Henrik Rothe, te veproje si kryearbiter te cilen ai e pranoi.

Pasi u kryen njoftimet e nevojshme per palet ne proces, si per GRM ashtu edhe per TPD Gjykata e Arbitrazhit shqyrtoi dokumentacionin e nevojshem dhe provat e paraqitura nga paditesi GRM. I padituri TPD ndonese i njoftuar per fillimin e procedurave te arbitrazhit nuk paraqiti asnje pretendim apo kundershtim. Pala e paditur TPD nuk beri asnje kerkese ne gjykaten e arbitrazhit.

Ne perfundim te shqyrtimit te ceshtjes, gjykata e arbitrazhit konstatoi qe GRM ka zgjidhur me te drejte kontratat me TPD ne daten 27 Maj 2015, pasi pagesa ne lidhje me Thirrjet (Kerkesat) Marxhinale te meparshme, ne lidhje me shumat e detyruara, nuk eshte kryer. Per sa i perket dokumentacionit per kerkesen kryesore gjykata e arbitrazhit konstatoi se Pasqyra C-14 (bashkelidhur vendimit te arbitrazhit) eshte prove e mjaftueshme per kerkesen e paditesit per pagesen e 337,440 USD. Sipas paragrafit 9.1.4 i padituri duhet te paguaje interesin e kesaj shume te barabarte me USD LIBOR + 10 % nga 27 Maji 2015. Gjykata e arbitrazhit vendosi qe kostoja e arbitrazhit ka vleren e DKK 140,000. GRM ka pasur nje arsye te forte per te filluar procedurat e arbitrazhit dhe vendimi eshte dhene ne favor te GRM. Gjykata vendos qe TPD duhet te mbuloje kostot ligjore te GRM me 90,000 DKK.
Ne perfundim te procedurave te arbitrazhit, gjykata e arbitrazhit, ne date 04. 03.2016, vendosi qe:

- TPD (Trading Petrol and Drilling SH.A) duhet ti paguaje Global Risk Management Ltd 337,440.00 USD me interes me norme interesi te barabarte me 1-muaj USD bazuar ne LIBOR +10% nga 27 Maj 2015 deri ne pagese te plote;
- TPD (Trading Petrol and Drilling SH.A) do te mbuloje te gjitha shpenzimet e procedurave duke perfshire tarifat dhe shpenzimete gjykates me 140,000 DKK;
- TPD (Tading Petrol and Drilling SH.A) do te rimbursoje Global Risk Management Ltd per te gjitha shpenzimet lidhur me procedurat e arbitrazhit me 90,000 DKK me interes sipas Aktit te Interesit danez 8a .

Ne lidhje me vendimin e gjykates se arbitrazhit si me lart, konkretisht, nuk rezulton te ekzistojne ndonje nga pengesat qe parashikohen ne nenin 394 te Kodit te Procedures Civile, ashtu sikunder ndonje prej pengesave te parashikuara ne nenin 5 te Konventes "Per njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve te huaja te arbitrazhit" (Konventa e New Yorkut 1958), Konvente ne te cilen aderon dhe Republika e Shqiperise sipas Ligjit Nr.8688, date 09.11.2000.

Me tej, nuk rezulton qe ne rastin konkret te kete ndonje nga pengesat e percaktuara nga pikat a), b), d) dhe dh) te nenit 394 i K.Pr.Civile (nuk vertetohet e kunderta), dhe nga ana tjeter ne baze te vertetimit te leshuar nga ana e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nuk rezulton qe midis te njejtave pale te kete aktualisht ndonje ceshtje gjyqesore per te njejtin objekt.
Me konkretisht referuar nenit 394 ne lidhje me nenin 399 te Kodit te Procedures Civile, rezulton qe ne lidhje me ceshtjen ne fjale midis paleve GRM dhe TPD si dhe ne lidhje me vendimin e arbitrazhit te dhene ne Kopenhagen ne daten 04.03.2016:
- legjislacioni shqiptar te mos parashikoje pengese per zgjidhjen me arbitrazh, qofte dhe te huaj, te mosmarreveshjes mes paleve ndergjyqese;
- te mos kete pretendime nga pala e paditur ne ate rast per mos sigurimin e garancive te nevojshme per t'u mbrojtur gjate gjykimit te mosmarreveshjes nga gjykata e arbitrazhit te huaj;
- gjykata shqiptare nuk ka dhene vendim per ato pale, per te njejten mosmarreveshje apo per kontraten mes tyre;
- vendimi i gjykates se arbitrazhit te huaj ka marre forme te prere sipas rregullave te legjislacionit te vendit ku eshte realizuar procedura e arbitrazhit;
- vendimi i gjykates se arbitrazhit te huaj te mos jete ne kundershtim me parimet baze te legjislacionit shqiptar.

Vendimi i Gjykates se Arbitrazhit Nderkombetar nuk vjen ndesh as me Nenin 5 te Konventes se New York-ut " Per njohejn dhe ekzekutimin e vendimeve te arbitrazhit te huaj", me te cilen vendi yne eshte bere pale. Ne kushtet kur vendimi i arbitrazhit nuk ka pengesa ligjore, gjykojme se ai duhet te njihet dhe t'i jepet fuqi zbatimi ne Republiken e Shqiperise.

Ky keshill gjyqesor i Gjykates se Apelit Tirane, cmon se Gjykata e Arbitrazhit Nderkombetar gjate gjykimit te ceshtjes se pjesmarresve ne kete proces dhe marrjes se vendimit ka zhvillur nje proces te rregullt gjyqesor ne kuptimin e nenit 6 pika 1 te Konventes Europiane te te drejtave dhe Lirive Themelore te Njeriut ne te cilen theksohet:
“Cdo person ka te drejte qe ceshtja e tij te degjohet drejtesisht, publikisht dhe brenda nje afati te arsyeshem nga nje gjykate e pavarur dhe e paanshme e krijuar ligjerisht...".
Midis paleve ne proces ka patur nje kontrate dhe me vullnetin e tyre te brendshem kane pranuar pikerisht arbitrazhin per zgjidhjen e mosmarreveshjeve. Prane gjykates se arbitrazhit eshte zhvilluar nje proces i drejte duke u mbeshtetur ne te gjithe legjslacionin dhe aktet nderkombetare te ratifikuara nga shteti shqiptar rreth zhvillimit te arbitrazhit.
Ne keto kushte, perfundimisht, ky keshill gjyqesor i Gjykates se Apelit Tirane, cmon se kerkesa e kerkuesit duhet te pranohet si nje kerkese e drejte. Si rrjedhoje duhet te vendoset njohja dhe dhenia fuqi per zbatim ne Republiken e Shqiperse e vendimit te arbitrazhit te dhene ne Kopenhagen, Danimarke ne date 04.03.2016.

P E R K E T O A R S Y E

Bazuar ne nenin 395,396, 397 e 399 te Kodit te Procedures Civile gjykata:

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses se kerkuesit A/S Global Risk Managment Ltd.
Njohje dhe dhenie fuqi ne Republiken e Shqiperise se vendimit te arbitrazhit date 04.03.2016 dhene ne Kopenhagen, Danimarke, midis paleve A/S Global Risk Managment Ltd dhe Tradin Petrol & Drilling sh.a.
Leshimin e urdherit te ekzekutimit te ketij vendimi.
Kunder vendimit lejohet rekurs ne Gjykaten e Larte.

Tiranë më 24.11.2016

ANETAR	**ANETARE**	**KRYESUESE**
ERVIN METALLA	**MARIA QIRJAZI**	**FIQIRETE MULLAJ**

Vërtetohet se ky vendim ka marrë formë të prerë
KANCELARE
Lertida BALILI